

BASHKIA E TIRANËS

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i Proedures: “Mirëmbajtje e Platformës e-Rekrutim”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV):): 98390000-3 Shërbime të tjera

Vlera e fondit limit: 3,360,000 (tre milion e treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 10

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

Neni 82, i LPP i ndryshuar, “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, si dhe shtojcës 9 të DST-së.*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a. Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit që prokurohet, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr.922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

b. Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (**2022, 2023, 2024**) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

c. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin për vitin 2024 dhe për kestin përkatës të vitit 2025 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Shënim: *** Kriteri 2.2.c konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 10. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore sipas kësteve pranë bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

- a) Operatori ekonomik për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë kontrata të shoqëruara me vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara të nënshkruara nga të dyja palët.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, neni 77 të Ligjit nr.

162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar), “...Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës...” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, “...Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës...”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

3. Operatori Ekonomik duhet të disponojë një punësim mesatar i të paktën 4 (katër) personave, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për muajin e fundit të deklaruar si dhe listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatese sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar), ku parashikohet “...Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”, dhe nenin 41, pika 4, gërma ”c” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, “...Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti

kontraktor kërkon: c. fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;...”.

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zërin e preventivit, me afatin e kryerjes së shërbimit sipas grafikut të shërbimeve, që është përlogaritur për një kohë të caktuar i cili kërkon fuqi punëtore dhe me mjetet e kërkuara për realizimin me sukses të kësaj kontrate shërbimi.

Gjithashtu Njësia e Prokurimit për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore dhe stabilitetin e saj ka kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur në pikën 6, neni 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, sipas së cilës: “...Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës...”.

*Shënim: Me këtë numër minimal të kërkuar synohet të garantohet gjatë gjithë kohës ofrimi i shërbimit dhe parandalohen rastet e pamundësisë së prezencës së stafit për arsye të ndryshme objektive (leje vjetore, raport mjekësor, trajnime, etj.)

4. Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf të kualifikuar për kryerjen e të gjitha shërbimeve të vërtetuar me certifikata/transkripte përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi muajin e fundit të deklaruar, si më poshtë:

- a.1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti.
- b.Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si zhvillues në web.
- c.2 (dy) punonjës të certifikuar për programim C# në .NET.
- d.Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si administrator databaze.
- e.1 (një) punonjës të certifikuar për Testues software.

Shënim: Një punonjës mund të ketë më shumë se një certifikim.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: Certifikata/Transkripte përkatëse për specialistët e kërkuar.

Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik (emër mbiemër)/ profilin (certifikimet) e punonjesve nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Listëpagesat sipas formularit eSig25 për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku përfshihet stafi si më sipër.

Argumentimi: Kërkesa për staf është hartuar në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “...Për miratimin e rregullave të prokurimit publik...” i ndryshuar, Neni 41, pika 4, ku citohet: “...Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të

prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë...”

-1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti;

Argumentimi: Operatori ekonomik duhet të ketë 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti, për të siguruar mbarëvajtjen e suksesshme të platformës objekt i kësaj kontrate, sipas standardeve dhe praktikave më të mira duke marrë në konsideratë rëndësinë dhe kompleksitetin e platformës.

Menaxheri i projektit duhet të jetë përgjegjës për ndjekjen e të gjithë ciklit të një software, duke analizuar, dizenuar dhe implementuar kërkesat e raportuara nga Operatori Ekonomik dhe për ndjekjen e konfigurimeve të sistemit, testimet dhe dokumentimin e tij.

Menaxheri i projektit duke marrë parasysh kompleksitetin e platformës dhe afatet kohore të kryerjes së shërbimit, duhet të sigurojë që shërbimi të ofrohet me sukses dhe cilësi sipas përcaktimeve të kësaj kontrate.

- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si zhvillues në web.

Argumentimi: Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si zhvillues web për mirëmbajtjen e platformës objekt i kësaj kontrate. Duke qenë se platforma që do të mirëmbahet është e bazuar në web, operatori ekonomik duhet të ketë punonjës të certifikuar në versionet e përditësuara të parimeve kryesore të web-it si HTML5, Java Script dhe CSS3, të cilët duhet të bëjnë të mundur ruajtjen e integritetit të anës grafike të platformës (ruajtjen e pamjes, strukturës, koherencës dhe funksionimit vizual të saj).

-2 (dy) punonjës të certifikuar për programim C# në NET.

Argumentimi: Duke qenë se platforma e-Rekrutimi është e zhvilluar në teknologji C#.NET dhe kërkon përmirësime/modifikime të vazhdueshme, është e domosdoshme të sigurohen të paktën dy programues të certifikuar.

Një zhvillues i certifikuar për C# në .NET është një profesionist i certifikuar për të programuar i cili përmbush standardet minimale dhe profesionale për të zhvilluar/mirëmbajtur/përmirësuar një sistem/platformë. Kërkesa për zhvillues të certifikuar për C# në .NET, është e bazuar dhe e lidhur ngushtësisht me objektin e kontratës e cila i referohet platformës e-Rekrutimi, duke përmbushur të gjitha funksionalitetet dhe kërkesat nga autoritetit kontraktor.

- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si administrator database

Argumentimi: Duke qenë se në këtë procedurë prokurimi do të bëhet mirëmbajtja e platformës, do të duhet që operatori ekonomik të ketë të paktën një punonjës të certifikuar si administrator database për menaxhimin, ruajtjen dhe sigurimin e disponueshmërinë se të dhënave të prodhuara dhe të përdorura nga software.

Përfshirja e të paktën një punonjësi të certifikuar si administrator database, për administrimin e bazës së të dhënave është e rëndësishme për sigurimin e integritetit, performancës dhe disponueshmërisë së të dhënave në një projekt. Një punonjës i certifikuar për databazë siguron që strukturat e të dhënave të modelohen në mënyrë të qëndrueshme, pyetjet dhe raportimet të ekzekutohen në mënyrë të optimizuar, dhe integriteti logjik i të dhënave të garantohet gjatë

gjithë ciklit të jetës së aplikacionit.

Gjithashtu, nëse databaza nuk administrohet nga personel i kualifikuar, rritet ndjeshëm rreziku për gabime, humbje të dhënash ose cenim të performancës së sistemit. Administratori i databazës është në gjendje të menaxhojnë sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave, duke implementuar strategji të sigurisë dhe duke monitoruar aktivitetin për të zbuluar dhe trajtuar rreziqe të mundshme. Përveç kësaj, punonjësit e certifikuar për administrator databaze nevojiten për të optimizuar performancën e bazës së të dhënave, duke ndjekur praktikat më të mira dhe duke identifikuar dhe eliminuar shkaqet e problemeve të performancës. Kjo kontribuon në përmirësimin e efikasitetit dhe në garantimin e qëndrueshmërisë së sistemit të bazës së të dhënave gjatë gjithë ciklit të jetës së sistemit/platformës.

-1 (një) punonjës të certifikuar për Testues Software.

Argumentimi: Përfshirja e një punonjësi të certifikuar për testime software, garanton një qasje profesionale dhe të specializuar në testimin e vazhdueshëm të platformës për të evidentuar problematika që mund të shfaqen në vijimësi.

Testuesi software duhet të ketë njohuri në strategjitë dhe metodologjitë e testimit, duke siguruar cilësi të lartë dhe performancë të përmirësuar. Një punonjës i certifikuar për testimin e software duhet të jetë i aftë të kryej teste të hollësishme të softwerit në vijimësi, duke identifikuar gabimet dhe dobësitë që mund të ndikojnë në performancën e platformës. Ky proces është kritik për të siguruar që platforma do të funksionojë në mënyrë të besueshme dhe pa rrezik për ndërprerje.

Përfshirja e një specialisti të certifikuar për testim software në projekt, garanton AK që përditësimet e platformës nuk do të ndikojnë/sjellin keqfunksionim apo ndërprerje të proceseve të punës, por ato do të implementohen gjithmonë pasi është validuar saktësia dhe plotësia e tyre.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ose ekuivalente të tyre të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

- a.** Standardin ISO 9001-2015 (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO-2015 sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.)

- b.** Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standartin ISO 20000-1 për sistemin e menaxhimit të shërbimit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 20000-1 (ose ekuivalente) sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes).

c. Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standartin ISO 27001, për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 27001 (ose ekuivalente), sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), në të cilin citohet “...Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit...”, si dhe në përputhje me pikën 1 të nenit 44, të VKM-se Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku citohet

“...Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”.

a. ISO 9001, për sistemin e menaxhimit të cilësisë;

Argumentimi: ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi I produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e kontratës.

b)ISO 20000-1 për sistemin e menaxhimit të shërbimit të teknologjisë së informacionit;

Argumentimi: Standardi ISO 20000-1:2011 (e përditësuar) përcakton kriteret për planifikimin, krijimin, menaxhimin, monitorimin, rishikimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e qasjes së menaxhimit të shërbimeve që fokusohet në teknologjitë e informacionit.

Kjo certifikatë siguron Autoritetin Kontraktor që të gjitha shërbimet IT që do të realizohen përgjatë fazave të kontratës, do të menaxhohen sipas standardeve më të mira të shërbimeve të teknologjisë së informacionit.

Këto kërkesa janë në vetvete një garanci më tepër për suksesin e projektit

c.ISO 27001 për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit;

Argumentimi: ISO 27001 është një kuadër standartizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me :

- mirëmbajtjen e sistemit ISMS (Information Security Management System) brenda vetë organizatës së operatorit ekonomik.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për menaxhimin e risqeve të sigurisë.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për trajtimin e të dhënave sensitive.
- aplikimin e masave dhe praktikave të sigurisë për shërbimet e kryera në ambiente sensitive.

Referuar sa më sipër cituar, ky standard i kërkuar, lidhet ngushtësisht dhe drejtpërdrejtë me zërat e kërkuara objekt kontrate, konkretisht:

“Objekti kryesor i këtij shërbimi është mirëmbajtja e platformës e-Rekrutimi, në çdo komponent të saj, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së punës.

Komponentët kryesore objekt i drejtpërdrejtë i shërbimit të mirëmbajtjes, përfshijnë:

- *Shërbimi i mirëmbajtjes së platformës e-Rekrutim në gjithë komponentët e saj.*
- *Shërbimi i mirëmbajtjes së bazës së të dhënave*
- *Përditësimi i teknologjive software në të cilën operon platforma*
- *Shërbimi i mirëmbajtjes për aplikacionet dhe shërbimet e konfiguruar.*

Krahas objektit kryesor të mirëmbajtjes, nëpërmjet kësaj kontrate shërbimi do të përfitohet edhe përmirësimi i platformës.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre.

Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

5. Argumentimi i specifikimeve teknike (termave të referencës):

Nëpërmjet kësaj kontrate synohet mirëmbajtja dhe suporti teknik për funksionimin dhe përdorimin normal të platformës e-Rekrutim, duke përfshirë çdo komponent të saj, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së punës.

Komponentët kryesore objekt i drejtpërdrejtë i shërbimit të mirëmbajtjes, përfshijnë:

- Shërbimi i mirëmbajtjes së platformës e-Rekrutim në gjithë komponentët e saj:

- o Autentifikimi dhe autorizimi
- o Menaxhimi i aplikantëve
- o Menaxhimi i pozicioneve
- o Menaxhimi i fazave dhe aplikimeve
- o Gjurmimi i historikut të aplikantëve
- o Vlerësimi i Aplikantëve
- o Raportet

- Shërbimi i mirëmbajtjes së bazës së të dhënave.

- Përditësimi i teknologjive software në të cilën operon platforma.

- Shërbimi i mirëmbajtjes për aplikacionet dhe shërbimet e konfiguruar.

Krahas objektit kryesor të mirëmbajtjes, nëpërmjet kësaj kontrate shërbimi do të përfitohet edhe përmirësimi i platformës.

Mirëmbajtja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i platformës siguron mirëfunksionimin e saj, rrit efikasitetin dhe garanton që informacioni i ofruar do të jetë gjithmonë i saktë dhe i aksesueshëm në kohë reale.

Termat e referencës dhe kërkesat funksionale janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 36, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) , si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor si dhe të marrë masat në kohën e duhur që të garantojë kapacitetet për përmbushjen me sukses të kontratës sipas kushteve të përcaktuara.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim ne vemendje se:

- Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë formularin e ofertës sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën 1, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.
- Gjithashtu Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë edhe listën e çmimeve të shërbimeve i cili është vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.
- Dokumentet perkatese vertetuese per disponimin e punonjësve do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.
- Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit te njoftimit te fuesit do t'i kërkojë ofertuesit te kualifikuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të paraqitura ne sistemin elektronik të prokurimit gjate fazës së ofertimit. Mosparaqitja e dokumentacionit të sipërcituar do te jete kusht s'kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimet e bera në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht skualifikimi.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar të njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Mirëmbajtje e Platformës e-Rekrutim”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.